



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

*VENDIM*

**Nr.192, Datë 30.08.2018**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“AEE” SH.P.K, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3 të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “*Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s*”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.08.2018 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AEE“ sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AEE” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se:**

Shoqëria “AEE” sh.p.k., me shkresën nr. 555 Prot, datë 16.08.2018, ka paraqitur kërkesën për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit.

Aplikimi i shoqërisë “AEE” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AEE” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**